

VENDIM
Nr.14, datë 15.3.2007

**PËR SKEMËN EKZISTUESE “PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË
PUNËKËRKUESEVE TË PAPUNA FEMRA”**

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

Z. Genc Ruli	Kryetar
Znj. Mimoza Dhëmbi	Anëtare
Znj. Mimoza Vokshi	Anëtare
Z. Viktor Gumi	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.3.2007 shqyrtoi raportin “Për skemën ekzistuese “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkueseve të papuna femra””. Raportimi është bërë pranë Drejtorisë së Ndhmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta me shkresën nr.295, datë 12.2.2007 dhe është regjistruar në regjistrin e DNSH-së me nr. AI/006/4/2005.

Baza ligjore: Si bazë për dhënien e ndihmës për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkueseve të papuna femra janë nenet 4 dhe 8 të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, si dhe pikat 1 dhe 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.632, datë 18.9.2003 “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkueseve të papuna femra”.

Objekti/vat: Skema synon të ndihmojë punëdhënësit, që punësojnë me kontratë të rregullt, me kohëzgjatje një deri në tre vjeçare, punëkërkuese të papuna femra, nga lista e zyrës së punësimit.

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Ndhmës Shtetërore dhe gjithë dokumentacionin mbështetës,

VËREN SE:

1. Skema, në parim, mbulon të gjitha ndërmarrjet/institucionet private, që kanë si qëllim marrjen, në punësim me kontratë të rregullt, punëkërkueseve të papuna femra nga lista e zyrës së punësimit të territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Intensiteti i ndihmës së dhënë për vitin e parë ose dy vitet e para së bashku është respektivisht 35,6% dhe 46,9%, duke qenë brenda kufijve të përcaktuar në ligjin nr.9374 datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, ndërsa kur skema zbatohet për të tre vitet së bashku, intensiteti është 56%, duke tejkaluar vlerën maksimale të përcaktuar në ligj.

3. Karakteri i përgjithshëm dhe i papërcaktuar i skemës, ndryshon me anë të urdhrave të nxjerrë çdo vit nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, sipas të cilëve bëhet rishikim i grupeve përfituese nga skema, si dhe përzgjedhja e sektorëve/ndërmarrjeve që kanë përparësi.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, mbështetur në bazë të nenit 10 shkronja “c” paragrafi 2 dhe nenit 23 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, nenit 19 të rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.817, datë 28.12.2005, si dhe nenit 6 pika 3 të rregullores “Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.815, datë 28.12.2005,

PROPOZON:

1. Në mënyrë që skema të jetë e lejueshme, intensiteti i ndihmës së dhënë të rishikohet kur skema zbatohet për tre vite ose duke ulur vlerën e kontributit të sigurimeve shoqërore, ose duke ulur numrin e pagave me të cilat kompensohet ndërmarrja.

2. Në rast se nuk merret parasysh propozimi i pikës 1, MPÇSSHB-ja kur zbaton skemën për

tre vite, duhet të vendosë kushtin që ndërmarrja të jetë e detyruar të ruajë vendet e punës edhe për të paktën dy vjet pas përfitimit të vitit të tretë të ndihmës.

3. Çdo projekturdhër i Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, lidhur me procedurat dhe kriteret e zbatimit të skemës, duhet të marrë miratimin paraprak të KNSH-ja.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Genc Ruli